



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E MBROJTJES  
MINISTRI

Nr. 3055/1 prot.

Tiranë, më 30. 3. 2026

URDHËR

Nr. 650, datë 30. 3. 2026

P Ë R

**MIRATIMIN E MODELEVE TË KONTRATËS "PËR KRYERJEN E SPECIALIZIMIT AFATGJATË NË MJEKËSI ME KUOTË TË MINISTRISË SË MBROJTJES DHE SHËRBIMIN E DETYRUESHËM NË FORCAT E ARMATOSURA"**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; të nenit 13, pika 2, shkronja "f", të ligjit nr. 64/2014 "Për pushtetet dhe autoritetet e drejtimit e të komandimit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar; të nenit 9, pika 2 të ligjit nr. 59/2014 "Për karrierën ushtarake në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar; të nenit 16, shkronja "ç" të ligjit nr. 9210/2004 "Për statusin e ushtarakut të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar; të neneve 77 dhe 78 të ligjit nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar; të neneve 481, 486, 541–545, 659, 660, 662, 663, 676, 690, 693 të Ligjit nr. 7850/1994, "Kodit Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar; të nenit 510, shkronja "d", dhe neneve 511 e vijues të Ligjit Nr. 8116, datë 29.3.1996 "Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë" i ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Miratimin e Modelit 1 të kontratës "Për kryerjen e specializimit afatgjatë në mjekësi me kuotë të Ministrisë së Mbrojtjes dhe shërbimin e detyrueshëm në FA", për personelin ushtarak dhe civil aktiv të Forcave të Armatosura, bashkëlidhur këtij urdhri si Aneks 1.
2. Miratimin e Modelit 2 të kontratës "Për kryerjen e specializimit afatgjatë në mjekësi me kuotë të Ministrisë së Mbrojtjes dhe shërbimin e detyrueshëm në FA", për civilët jashtë radhëve të Forcave të Armatosura, bashkëlidhur këtij urdhri si Aneks 2.
3. Periudha minimale e shërbimit të detyrueshëm pas diplomimit është 6 (gjashtë) vjet për të dyja kategoritë. Kohëzgjatja e specializimit dhe periudha e detyrueshme e shërbimit përcaktohen shprehimisht në çdo kontratë individuale.
4. Kur numri i kandidatëve që aplikojnë për kuotat e disponueshme tejkalon numrin e kuotave të miratuara, Drejtoria e Burimeve Njerëzore, në bashkëpunim me Inspektoratin

Shëndetësor, kryen një procedurë paraprake seleksionimi. Kandidatët që janë personel aktiv i Forcave të Armatosura kanë përparësi ndaj kandidatëve civilë jashtë radhëve të FA-së. Brenda secilës kategori, seleksionimi bëhet mbi bazën e meritave akademike dhe profesionale. Kriteret e hollësishme të seleksionimit përcaktohen me udhëzim të Ministrit të Mbrojtjes.

5. Aplikantit që seleksionohet për të përfutur nga kuotat e Specializimeve Afatgjata në Mjekësi për vitin akademik respektiv në një program të caktuar specializimi i lëshohet letër mbështetëse sipas formatit të përcaktuar në udhëzimin përkatës të Universitetit të Mjekësisë Tiranë, pas nënshkrimit para Noterit të kontratës individuale të lidhur mbi bazën e modeleve të miratuara me pikat 1 dhe 2 të këtij urdhri.
6. Urdhri i Ministrit të Mbrojtjes i lëshuar për ekzekutimin e kushtit penal sipas kontratave individuale, bashkë me kontratën e nënshkruar, përbëjnë titull ekzekutiv dhe ekzekutohen nga shërbimi përmbartimor gjyqësor sipas mekanizmave të parashikuara në kontratat përkatëse individuale dhe legjislacionit procedural në fuqi.
7. Urdhri i Ministrit nr. 856, datë 23.07.2020 "Për miratimin e kontratës "Për ndjekjen e studimeve të specializimit afatgjatë në fushën e mjekësisë nga personeli ushtarak dhe civil i Forcave të Armatosura dhe civilët jashtë radhëve të Forcave të Armatosura", shfuqizohet.
8. Ngarkohen për zbatimin e këtij urdhri Sekretari i Përgjithshëm dhe Drejtoria e Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Mbrojtjes, Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura dhe Kolegji i Mbrojtjes dhe Sigurisë.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

**MINISTRI**  
**Ermal Nufi**



## ANEKS 1

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**MINISTRIA E MBROJTJES**  
**SHTABI I PËRGJITHSHËM I FORCAVE TË ARMATOSURA**  
**KOLEGJI I MBROJTJES DHE SIGURISË**

*Adresa: Rruga e Dibrës, Tiranë; Tel: 0035542363465; Fax: 0035542369197*

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Datë \_\_\_\_ / \_\_\_\_ / \_\_\_\_\_

### K O N T R A T Ë

**PËR KRYERJEN E SPECIALIZIMIT AFATGJATË NË MJEKËSI ME KUOTË TË**  
**MINISTRISË SË MBROJTJES DHE SHËRBIMIN E DETYRUESHËM NË FORCAT E**  
**ARMATOSURA**

*(Personeli ushtarak dhe civil aktiv i Forcave të Armatosura)*

Sot, më datë \_\_\_\_ / \_\_\_\_ / \_\_\_\_\_, lidhet kjo kontratë midis palëve:

Komandantit të Kolegjit të Mbrojtjes dhe Sigurisë (KMS), \_\_\_\_\_,  
dhe

Z./Znj. \_\_\_\_\_, me \_\_\_\_\_ gradë/pozicion  
\_\_\_\_\_, me letërnjoftim nr. \_\_\_\_\_, personel aktiv i  
Forcave të Armatosura.

për:

kryerjen e Specializimit Afatgjatë në Mjekësi, në \_\_\_\_\_, në  
Universitetin e Mjekësisë, Tiranë, duke u regjistruar në vitin akademik \_\_\_\_\_ dhe për të gjithë  
kohëzgjatjen zyrtare të Specializimit Afatgjatë përkatës.

Me vullnet dhe dëshirë të lirë, palët bien dakord për sa më poshtë:

#### Neni 1

##### Objekti i kontratës

Kryerja e programit të ciklit të tretë të studimeve afatgjata në fushën e mjekësisë, për nevojat dhe në interes të Forcave të Armatosura (FA) të Republikës së Shqipërisë, dhe shërbimi i detyrueshëm pasues në Forcat e Armatosura, sipas nevojave dhe specializimit të kryer.

#### Neni 2

##### Baza ligjore

Kjo kontratë lidhet në bazë të:

- Neneve 481, 486, 541–545, 659, 660, 662, 663, 676, 690 dhe 693 të Ligjit nr. 7850/1994 “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar;
- Neneve 511 e vijues të Ligjit Nr. 8116, datë 29.3.1996 “Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar;
- Nenit 9, pika 2 e Ligjit nr. 59/2014 "Për karrierën ushtarake në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar;
- Nenit 16, shkronja "ç" dhe nenit 26 të Ligjit nr. 9210/2004 "Për statusin e ushtarakut të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar;
- Nenit 77 dhe nenit 78 të Ligjit nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në Republikën e Shqipërisë";
- Nenit 13, pika 2, shkronja "f" e Ligjit nr. 64/2014 "Për pushtetet dhe autoritetet e drejtimit e komandimit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar;
- Pikës 15 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 424/2024 "Për miratimin e strukturës së pagave, niveleve të pagave e shtesave mbi pagë, kompensimeve dhe trajtimeve të tjera financiare të punonjësve të sistemit shëndetësor, në institucionet shëndetësore, në sistemin e ministrisë përgjegjëse për shëndetësinë, në strukturat shëndetësore të forcave të armatosura të republikës së shqipërisë, të drejtorisë së përgjithshme të burgjeve dhe të drejtorisë së përgjithshme të policisë së shtetit", i ndryshuar;
- Rregullores në fuqi të specializimeve afatgjata dhe vendimit të Senatit Akademik të UMT-së për vitin akademik përkatës;
- Urdhrit të Ministrit të Mbrojtjes nr. \_\_\_\_\_, datë \_\_\_\_ / \_\_\_\_ / \_\_\_\_\_ “Për miratimin e modeleve të kontratës "Për kryerjen e specializimit afatgjatë në mjekësi me kuotë të Ministrisë së Mbrojtjes dhe shërbimin e detyrueshëm në Forcat e Armatosura””.

### **Neni 3**

#### **Kohëzgjatja e kontratës**

Kjo kontratë është e vlefshme për periudhën e studimeve pasuniversitare afatgjata, si dhe për periudhën e detyrueshme të shërbimit 6-vjeçar pas diplomimit. Kontrata mbetet në fuqi derisa specializanti të ketë përmbushur të gjitha detyrimet kontraktore sipas neneve 5 dhe 8.

### **Neni 4**

#### **Të drejtat dhe detyrimet e Ministrisë së Mbrojtjes**

1. Ministria e Mbrojtjes autorizon Z./Znj. \_\_\_\_\_ të kryejë specializimin afatgjatë në \_\_\_\_\_, duke filluar nga viti akademik \_\_\_\_\_ deri në përfundimin e kohëzgjatjes zyrtare të programit të specializimit përkatës, për nevojat e shërbimit shëndetësor të FA-së dhe, me nënshkrimin dhe hyrjen në fuqi të kësaj kontrate, i lëshon letër mbështetëse.
2. Ministria e Mbrojtjes, në bashkëpunim me Universitetin e Mjekësisë, Tiranë, krijon kushtet për arsimimin dhe kualifikimin brenda kompetencave dhe parashikimeve të kuadrit ligjor në fuqi.

3. Gjatë periudhës së specializimit, specializanti trajtohet financiarisht sipas kuadrit ligjor në fuqi: me 80% të pagës bruto mujore të pozicionit/specialitetit përkatës për specializimet brenda vendit, sipas legjislacionit në fuqi. Vitet akademike të persëritura për faj të specializantit nuk trajtohen financiarisht.
4. Ministria e Mbrojtjes, nëpërmjet Drejtorisë së Burimeve Njerëzore, merr informacionin periodik mbi mbarëvajtjen e studimeve. Informacioni administrohet në dosjet e specializantëve pranë KMS-së.
5. Pas përfundimit të specializimit dhe diplomimit, Ministria e Mbrojtjes krijon kushtet e nevojshme për rikthimin/vazhdimin e specializantit në strukturat shëndetësore të FA-së, sipas nevojave dhe specializimit të kryer.

## Neni 5

### Të drejtat dhe detyrimet e studentit

1. Studenti duhet të ndjekë rregullisht procesin mësimor dhe të zbatojë me korrektësi të gjitha rregulloret e UMT-së dhe kuadrin ligjor e rregullator në fuqi gjatë gjithë periudhës së vlefshmërisë së kësaj kontrate, duke përfshirë rregulloren e specializimeve, udhëzimet për procedurat e pranimit e regjistrimit, si dhe çdo akt tjetër të aplikueshëm.
2. Studenti duhet të përfundojë studimet brenda afatit të parashikuar. Mosrespektimi i detyrimeve akademike për faj të studentit aktivizon kushtet e nenit 8.
3. Studenti duhet të paraqitet në Ministrinë e Mbrojtjes në fund të çdo viti akademik dhe të japë informacionin e nevojshëm për ecurinë, performancën dhe të dhënat personale.
4. Brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga diplomimi, studenti duhet të paraqitet në KMS me dokumentacionin e plotë dhe të nënshkruajë aktin e rikthimit/caktimit në strukturat shëndetësore të FA-së.
5. Studenti detyrohet të shërbejë në strukturat shëndetësore të FA-së, sipas nevojave të Ministrisë së Mbrojtjes, për një periudhë minimale të detyrueshme prej 6 (gjashtë) vitesh nga data e rikthimit/caktimit pas diplomimit.
6. Përsëritja e vitit akademik për faj të studentit, e vërtetuar nga UMT, ngarkon specializantin me kusht penal sipas nenit 8.4.
7. Gjatë specializimit dhe pas rikthimit në FA, specializanti i nënshtrohet të gjithë legjislacionit dhe akteve ligjore e nënligjore në fuqi për personelin ushtarak/civil aktiv të FA-së.
8. Mosrespektimi i detyrimeve të parashikuara në pikat 1, 2, 4, 5 dhe 6 të këtij neni aktivizon penalitetet e nenit 8.

## Neni 6

### Të drejtat dhe detyrimet e KMS

1. Të plotësojë rregullisht dosjen personale fizike të personelit gjatë specializimit.

2. Të marrë, në fund të çdo viti akademik dhe në çdo kohë, informacionin e nevojshëm mbi ecurinë, performancën dhe të dhënat personale. Informacioni administrohet në dosjen personale.
3. Të presë personalisht personin në muajin korrik/gusht të çdo viti dhe të verifikojë dokumentacionin. Për mosparaqitje, informon Drejtorinë e Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Mbrojtjes.

## Neni 7

### Deklarata e specializantit

1. Me nënshkrimin e kësaj kontrate, specializanti deklaron nën përgjegjësinë e tij të plotë juridike se:
  - a. Ka lexuar dhe plotëson të gjitha kushtet e pranimin të parashikuara në Rregulloren e specializimeve afatgjata nr. \_\_\_\_\_, datë \_\_\_\_\_ (Shtojca 1 e kësaj kontrate) dhe në Udhëzimin nr. \_\_\_\_\_, datë \_\_\_\_\_ për vitin akademik \_\_\_\_\_ (Shtojca 2 e kësaj kontrate).
  - b. Zotëron të gjitha dokumentet dhe kualifikimet e nevojshme për aplikim dhe pranim, duke përfshirë njohjen e gjuhës së huaj të kërkuar dhe njohjen e diplomës nga UMT.
  - c. Është në gjendje shëndetësore të përshtatshme për ndjekjen e programit të specializimit dhe ushtrimin e profesionit përkatës.
  - d. Nuk ka lidhur kontratë të njëjtë ose të ngjashme me asnjë institucion tjetër për të aplikuar/ndjekur Specializimet Afatgjata në mjekësi për të njëjtin vit akademik dhe nuk do të lidhë të tillë pas nënshkrimit të kësaj kontrate.
2. Deklarata e rreme ose e pasaktë ngarkon specializantin me përgjegjësi të plotë dhe aktivizon penaltetin maksimal sipas nenit 8, pa asnjë zbutje.

## Neni 8

### Penalitetet dhe pasojat e mosplotësimit të detyrimeve

#### 8.1 Penaliteti për mosmbylljen e specializimit

Nëse studenti ndërpret specializimin ose nuk e përfundon atë brenda afatit të parashikuar, me përjashtim të rasteve të forcës madhore sipas nenit 9 të kësaj kontrate, studenti detyrohet:

- a) të paguajë kushtin penal të përcaktuar në këtë pikë, sipas neneve 541–545 të Kodit Civil, pavarësisht muajit të shkëputjes gjatë vitit akademik përkatës. Shuma e kushtit penal llogaritet sipas numrit të viteve akademike të përfunduara, përfshirë atë në proces, në momentin e ndërprerjes:

Viti akademik gjatë të cilit ndërpritet specializimi

Kushti penal

Ndërprerje gjatë vitit të 1-rë

500,000 lekë

Ndërprerje gjatë vitit të 2-të	1,000,000 lekë
Ndërprerje gjatë vitit të 3-të	1,500,000 lekë
Ndërprerje gjatë vitit të 4-t	2,000,000 lekë
Ndërprerje gjatë vitit të 5-të	2,500,000 lekë
Ndërprerje gjatë vitit të 6-të	3,000,000 lekë

b) të humbasë të drejtën për çdo mbështetje, kuotë studimi, rekrutim ose angazhim të ardhshëm nga Ministria e Mbrojtjes, Forcat e Armatosura dhe çdo institucion i varur ose i lidhur me Ministrinë e Mbrojtjes, për aq kohë sa detyrimi sipas shkronjës (a) nuk është shlyer plotësisht.

### **8.2 Penaliteti për moslidhjen e kontratës së punësimit pas diplomimit**

Nëse studenti, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga diplomimi, nuk paraqitet sipas nenit 5, pika 4, ose refuzon punësimin sipas nenit 5, pika 5, penaliteti llogaritet si shkëputje gjatë vitit të fundit të programit dhe korrespondon me numrin e viteve të programit të specializimit të parashikuar shumëzuar me 500,000 (pesëqind mijë) lekë.

### **8.3 Penaliteti për largimin e parakohshëm nga shërbimi**

Nëse specializanti largohet nga shërbimi në Forcat e Armatosura para përmbushjes së periudhës së detyrueshme 6 vjeçare, penaliteti llogaritet si shuma e pagës mujore bruto të pozicionit përkatës të mjekut në strukturat shëndetësore të FA-së, sipas legjislacionit në fuqi, për muajt e mbetur deri në përfundim të periudhës së detyrueshme.

### **8.4 Penaliteti për përsëritjen e vitit akademik**

Përsëritja e vitit akademik nga studenti, e vërtetuar me dokumentacion zyrtar nga UMT, ngarkon specializantin me kusht penal të barabartë me shumën e pagës mujore bruto të pozicionit përkatës të mjekut në strukturat shëndetësore të FA-së, sipas legjislacionit në fuqi, për periudhën 12-mujore.

### **8.5 Procedura e ekzekutimit**

- Ministria e Mbrojtjes njofton me shkrim specializantin për shkeljen e konstatuar, duke i dhënë 15 (pesëmbëdhjetë) ditë afat për të paraqitur kundërshtime me shkrim dhe dokumente justifikuese.
- Urdhri i Ministrit të Mbrojtjes për ekzekutimin e kushtit penal, bashkë me kontratën e nënshkruar, përbëjnë titull ekzekutiv. Ekzekutimi kryhet nga shërbimi përmbarimor gjyqësor sipas neneve 511 e vijues të Kodit të Procedurës Civile, pa pasur nevojë për gjykim paraprak.
- Shlyerja e plotë e kushtit penal sipas pikave 8.1(a), 8.2 dhe 8.3 heq efektin e kufizimit të parashikuar në pikën 8.1(b).

## **Neni 9**

### **Forca madhore**

1. Palët çlirohen nga detyrimet kontraktore dhe kushti penal nuk zbatohet në rast të forcës madhore, e cila përkufizohet si ngjarje e jashtëzakonshme, e paparashikueshme dhe e paevitueshme, e pavarur nga vullneti i palëve, e cila bën të pamundur ekzekutimin e detyrimit.
2. Pala që pretendon forcën madhore e njofton palën tjetër me shkrim brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga ndodhja e ngjarjes, duke bashkëlidhur dokumentacionin provues. Mosnjoftimi brenda afatit heq të drejtën e pretendimit të forcës madhore.

## Neni 10

### Dispozita të fundit

1. Mosmarrëveshjet që lindin gjatë zbatimit të kësaj kontrate zgjidhen me mirëkuptim midis palëve. Në rast të kundërt, palët i drejtohen Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.
2. Kjo kontratë, pasi u lexua dhe u kuptua, u nënshkrua me vullnetin e lirë e të plotë të palëve, para noterit dhe hyn në fuqi në momentin e nënshkrimit.
3. Kjo kontratë hartohet në tre kopje identike; 1 (një) qëndron në sekretarinë e KMS-së, 1 (një) vendoset në dosjen personale të studentit dhe 1 (një) i jepet aplikantit.
4. Bashkëlidhur kësaj kontrate si pjesë integrale janë:
  - a. Shtojca 1 – Rregullorja e specializimeve afatgjata nr. \_\_\_\_\_, datë \_\_\_\_\_;
  - b. Shtojca 2 – Udhëzimi nr. \_\_\_\_\_, datë \_\_\_\_\_ për procedurat e pranimit të vitit akademik \_\_\_\_\_.
5. Për problemet që lindin gjatë periudhës së studimeve, Ministria e Mbrojtjes kontakton familjen e personit në adresën: Rruga \_\_\_\_\_, Tiranë. Personi mund të kontaktojë Ministrinë e Mbrojtjes (KMS) në tel. +35542226601 / 6602, email [informimi\\_mm@mod.gov.al](mailto:informimi_mm@mod.gov.al)

## PALËT NËNSHKRUESE

**KOMANDANTI I KOLEGJIT TË  
MBROJTJES DHE SIGURISË**

**APLIKANTI**

\_\_\_\_\_  
(grada, emër, mbiemër)

\_\_\_\_\_  
(emër, atësi, mbiemër)

Konceptoi: \_\_\_\_\_  
Pranoi: \_\_\_\_\_  
Miratoi: \_\_\_\_\_  
Datë: \_\_\_\_\_

ANEKS 2

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E MBROJTJES  
SHTABI I PËRGGJITHSHËM I FORCAVE TË ARMATOSURA  
KOLEGJI I MBROJTJES DHE SIGURISË

Adresa: Rruga e Dibrës, Tiranë; Tel: 0035542363465; Fax: 0035542369197

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Datë \_\_\_\_ / \_\_\_\_ /

K O N T R A T Ë  
PËR KRYERJEN E SPECIALIZIMIT AFATGJATË NË MJEKËSI ME KUOTË TË  
MINISTRISË SË MBROJTJES DHE SHËRBIMIN E DETYRUESHËM NË FORCAT E  
ARMATOSURA

(Civilët jashtë radhëve të Forcave të Armatosura)

Sot, më datë \_\_\_\_ / \_\_\_\_ / \_\_\_\_\_, lidhet kjo kontratë midis palëve:

Komandantit të Kolegjit të Mbrojtjes dhe Sigurisë (KMS), \_\_\_\_\_,  
dhe Z./Znj. \_\_\_\_\_, me adresë:  
\_\_\_\_\_, me letërnjoftim nr. \_\_\_\_\_, madhor/e dhe  
me zotësi të plotë juridike për të vepruar.

për: kryerjen e Specializimit Afatgjatë në Mjekësi, në \_\_\_\_\_, në  
Universitetin e Mjekësisë, Tiranë, duke u regjistruar në vitin akademik \_\_\_\_\_ dhe për të gjithë  
kohëzgjatjen zyrtare të Specializimit afatgjatë përkatës.

Me vullnet dhe dëshirë të lirë, palët bien dakord për sa më poshtë:

**Neni 1**

**Objekti i kontratës**

Kryerja e programit të ciklit të tretë të studimeve afatgjata në fushën e mjekësisë, për nevojat dhe në interes të Forcave të Armatosura (FA) të Republikës së Shqipërisë, dhe shërbimi i detyrueshëm pasues në Forcat e Armatosura, sipas nevojave dhe specializimit të kryer.

**Neni 2**

**Baza ligjore**

Kjo kontratë lidhet në bazë të:

- Neneve 481, 486, 541-545, 659, 660, 662, 663, 676, 690 dhe 693 të Ligjit nr. 7850/1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar;
- Nenet 510, shkronja "d", dhe neneve 511 e vijues të Ligjit Nr. 8116, datë 29.3.1996 "Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë" i ndryshuar;
- Nenet 9, pika 2 të Ligjit nr. 59/2014 "Për karrierën ushtarake në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar;
- Nenet 77 dhe nenet 78 të Ligjit nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në Republikën e Shqipërisë";
- Nenet 13, pika 2, shkronja "f" të Ligjit nr. 64/2014 "Për pushtetet dhe autoritetet e drejtimit e komandimit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar;
- Rregullores në fuqi të specializimeve afatgjata dhe vendimit të Senatit Akademik të UMT-së për vitin akademik përkatës;
- Urdhrit të Ministrit të Mbrojtjes nr. \_\_\_\_\_, datë \_\_\_\_ / \_\_\_\_ / \_\_\_\_\_ "Për miratimin e modeleve të kontratës "Për kryerjen e specializimit afatgjatë në mjekësi me kuotë të Ministrisë së Mbrojtjes dhe shërbimin e detyrueshëm në Forcat e Armatosura"

### Neni 3

#### Kohëzgjatja e kontratës

Kjo kontratë është e vlefshme për periudhën e studimeve pasuniversitare afatgjata, plus periudhën e detyrueshme të shërbimit 6-vjeçar pas diplomimit. Kontrata mbetet në fuqi derisa specializanti të ketë përmbushur të gjitha detyrimet kontraktore sipas neneve 5 dhe 8.

### Neni 4

#### Të drejtat dhe detyrimet e Ministrisë së Mbrojtjes

1. Ministria e Mbrojtjes mbështet Z./Znj. \_\_\_\_\_ të kryejë specializimin afatgjatë në \_\_\_\_\_, duke filluar nga viti akademik \_\_\_\_\_ deri në përfundimin e kohëzgjatjes zyrtare të programit të specializimit përkatës, për nevojat e shërbimit shëndetësor të FA-së dhe, me nënshkrimin dhe hyrjen në fuqi të kësaj kontrate, i lëshon letër mbështetëse.
2. Ministria e Mbrojtjes, në bashkëpunim me Universitetin e Mjekësisë, Tiranë, krijon kushtet për arsimimin dhe kualifikimin brenda kompetencave dhe parashikimeve të kuadrit ligjor në fuqi.
3. Ministria e Mbrojtjes nuk garanton asnjë lloj trajtimi financiar për studentët jashtë radhëve të FA-së gjatë periudhës së specializimit.
4. Ministria e Mbrojtjes nëpërmjet Drejtorisë së Burimeve Njerëzore, merr informacionin periodik mbi mbarëvajtjen e studimeve. Informacioni administrohet në dosjet e specializantëve pranë KMS-së.

5. Pas përfundimit të specializimit dhe diplomimit, Ministria e Mbrojtjes krijon kushtet e nevojshme për punësimin e specializantit në strukturat shëndetësore të FA-së, sipas nevojave dhe specializimit të kryer.

## **Neni 5**

### **Të drejtat dhe detyrimet e studentit**

1. Studenti duhet të ndjekë rregullisht procesin mësimor dhe të zbatojë me korrektësi të gjitha rregulloret e UMT-së dhe kuadrin ligjor e rregullator në fuqi gjatë gjithë periudhës së vlefshmërisë së kësaj kontrate, duke përfshirë rregulloren e specializimeve, udhëzimet për procedurat e pranimit e regjistrimit, si dhe çdo akt tjetër të aplikueshëm.
2. Studenti duhet të përfundojë studimet brenda afatit të parashikuar. Mosrespektimi i detyrimeve akademike për faj të studentit aktivizon kushtet e nenit 8.
3. Studenti duhet të paraqitet në Ministrinë e Mbrojtjes në fund të çdo viti akademik dhe të japë informacionin e nevojshëm për ecurinë, performancën dhe të dhënat personale.
4. Brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga diplomimi, studenti duhet të paraqitet në KMS me dokumentacionin e plotë dhe të nënshkruajë kontratën e punësimit me strukturat shëndetësore të FA-së.
5. Studenti detyrohet të shërbejë në strukturat shëndetësore të FA-së, sipas nevojave të Ministrisë së Mbrojtjes, për një periudhë minimale të detyrueshme prej 6 (gjashtë) vitesh nga data e nënshkrimit të kontratës së punësimit.
6. Persëritja e vitit akademik për faj të studentit, e vërtetuar nga UMT, ngarkon specializantin me kusht penal sipas nenit 8.4.
7. Pas punësimit në strukturat shëndetësore të FA-së, specializanti i nënshtrohet të gjithë legjislacionit dhe akteve ligjore e nënligjore në fuqi për personelin mjekësor civil të FA-së.
8. Mosrespektimi i detyrimeve të parashikuara në pikat 1, 2, 4, 5 dhe 6 të këtij neni aktivizon penalitetet e nenit 8.

## **Neni 6**

### **Të drejtat dhe detyrimet e KMS**

1. Të plotësojë rregullisht dosjen personale fizike të personelit gjatë specializimit.
2. Të marrë, në fund të çdo viti akademik dhe në çdo kohë, informacionin e nevojshëm mbi ecurinë, performancën dhe të dhënat personale. Informacioni administrohet në dosjen personale.
3. Të presë personalisht personin në muajin korrik/gusht të çdo viti dhe të verifikojë dokumentacionin. Për mosparaqitje, informon Drejtorinë e Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Mbrojtjes.

## Neni 7

### Deklarata e specializantit

1. Me nënshkrimin e kësaj kontrate, specializanti deklaron nën përgjegjësinë e tij të plotë juridike se:
  - a. Ka lexuar dhe plotëson të gjitha kushtet e pranimit të parashikuara në Rregulloren e specializimeve afatgjata nr. \_\_\_\_\_, datë \_\_\_\_\_ (Shtojca 1 e kësaj kontrate) dhe në Udhëzimin nr. \_\_\_\_\_, datë \_\_\_\_\_ për vitin akademik \_\_\_\_\_ (Shtojca 2 e kësaj kontrate).
  - b. Zotëron të gjitha dokumentet dhe kualifikimet e nevojshme për aplikim dhe pranim, duke përfshirë njohjen e gjuhës së huaj të kërkuar dhe njohjen e diplomës nga UMT.
  - c. Është në gjendje shëndetësore të përshtatshme për ndjekjen e programit të specializimit dhe ushtrimin e profesionit përkatës.
  - d. Nuk ka lidhur kontratë të njëjtë ose të ngjashme me asnjë institucion tjetër për të aplikuar/ndjekur Specializimet Afatgjata në mjekësi për të njëjtin vit akademik dhe nuk do të lidhë të tillë pas nënshkrimit të kësaj kontrate.
2. Deklarata e rreme ose e pasaktë ngarkon specializantin me përgjegjësi të plotë dhe aktivizon penalitetin maksimal sipas nenit 8, pa asnjë zbutje.

## Neni 8

### Penalitetet dhe pasojat e mosplotësimit të detyrimeve

#### 8.1 Penaliteti për mosmbylljen e specializimit

Nëse studenti ndërpret specializimin ose nuk e përfundon atë brenda afatit të parashikuar, me përjashtim të rasteve të forcës madhore sipas nenit 9 të kësaj kontrate, studenti detyrohet:

a) të paguajë kushtin penal të përcaktuar në këtë pikë, sipas neneve 541-545 të Kodit Civil, pavarësisht muajit të shkëputjes gjatë vitit akademik përkatës. Shuma e kushtit penal llogaritet sipas numrit të viteve akademike të përfunduara, përfshirë atë në proces, në momentin e ndërprerjes:

Viti akademik gjatë të cilit ndërpritet specializimi	Kushti penal
Ndërprerje gjatë vitit të 1-rë	500,000 lekë
Ndërprerje gjatë vitit të 2-të	1,000,000 lekë
Ndërprerje gjatë vitit të 3-të	1,500,000 lekë
Ndërprerje gjatë vitit të 4-t	2,000,000 lekë
Ndërprerje gjatë vitit të 5-të	2,500,000 lekë
Ndërprerje gjatë vitit të 6-të	3,000,000 lekë

b) të humbasë të drejtën për çdo mbështetje, kuotë studimi, rekrutim ose angazhim të ardhshëm nga Ministria e Mbrojtjes, Forcat e Armatosura dhe çdo institucion i varur ose i lidhur me Ministrinë e Mbrojtjes, për aq kohë sa detyrimi sipas shkronjës (a) nuk është shlyer plotësisht.

### **8.2 Penaliteti për moslidhjen e kontratës së punësimit pas diplomimit**

Nëse studenti, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga diplomimi, nuk paraqitet sipas nenit 5, pika 4, ose refuzon punësimin sipas nenit 5, pika 5, penaliteti llogaritet si shkëputje gjatë vitit të fundit të programit dhe korrespondon me numrin e viteve të programit të specializimit të parashikuar shumëzuar me 500,000 (pesëqind mijë) lekë.

### **8.3 Penaliteti për largimin e parakohshëm nga shërbimi**

Nëse specialisti largohet nga shërbimi në Forcat e Armatosura para përbushjes së periudhës së detyrueshme 6 vjeçare, penaliteti llogaritet si shuma e pagës mujore bruto të pozicionit përkatës të mjekut në strukturat shëndetësore të FA-së, sipas legjislacionit në fuqi, për muajt e mbetur deri në përfundim të periudhës së detyrueshme.

### **8.4 Penaliteti për persëritjen e vitit akademik**

Persëritja e vitit akademik nga studenti, e vërtetuar me dokumentacion zyrtar nga UMT, ngarkon specialistin me kusht penal të barabartë me shumën e pagës mujore bruto të pozicionit përkatës të mjekut në strukturat shëndetësore të FA-së, sipas legjislacionit në fuqi, për periudhën 12-mujore.

### **8.5 Procedura e ekzekutimit**

- a. Ministria e Mbrojtjes njofton me shkrim specialistin për shkeljen e konstatuar, duke i dhënë 15 (pesëmbëdhjetë) ditë afat për të paraqitur kundërshtime me shkrim dhe dokumente justifikuese.
- b. Urdhri i Ministrisë së Mbrojtjes për ekzekutimin e kushtit penal, bashkë me kontratën e nënshkruar, përbëjnë titull ekzekutiv. Ekzekutimi kryhet nga shërbimi përmbarimor gjyqësor sipas neneve 511 e vijues të Kodit të Procedurës Civile, pa pasur nevojë për gjykim paraprak.
- c. Shlyerja e plotë e kushtit penal sipas pikave 8.1(a), 8.2 dhe 8.3 heq efektin e kufizimit të parashikuar në pikën 8.1(b).

## **Neni 9**

### **Forca madhore**

1. Palët çlirohen nga detyrimet kontraktore dhe kushti penal nuk zbatohet në rast të forcës madhore, e cila përkufizohet si ngjarje e jashtëzakonshme, e paparashikueshme dhe e paevitueshme, e pavarur nga vullneti i palëve, e cila bën të pamundur ekzekutimin e detyrimit.
2. Pala që pretendon forcën madhore e njofton palën tjetër me shkrim brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga ndodhja e ngjarjes, duke bashkëlidhur dokumentacionin provues. Mosnjoftimi brenda afatit heq të drejtën e pretendimit të forcës madhore.

**Neni 10**  
**Dispozita të fundit**

1. Mosmarrëveshjet që lindin gjatë zbatimit të kësaj kontrate zgjidhen me mirëkuptim midis palëve. Në rast të kundërt, palët i drejtohen Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.
2. Kjo kontratë, pasi u lexua dhe u kuptua, u nënshkrua me vullnetin e lirë e të plotë të palëve, para noterit dhe hyn në fuqi në momentin e nënshkrimit.
3. Kjo kontratë hartohet në tre kopje identike; 1 (një) qëndron në sekretarinë e KMS-së, 1 (një) vendoset në dosjen personale të studentit dhe 1 (një) i jepet aplikantit.
4. Bashkëlidhur kësaj kontrate si pjesë integrale janë:
  - a. Shtojca 1 – Rregullorja e specializimeve afatgjata nr. \_\_\_\_\_, datë \_\_\_\_\_;
  - b. Shtojca 2 – Udhëzimi nr. \_\_\_\_\_, datë \_\_\_\_\_ për procedurat e pranimit të vitit akademik \_\_\_\_\_.
5. Për problemet që lindin gjatë periudhës së studimeve, Ministria e Mbrojtjes kontakton familjen e personit në adresën: Rruga \_\_\_\_\_, Tiranë. Personi mund të kontaktojë Ministrinë e Mbrojtjes (KMS) në tel. +35542226601 / 6602, email informimi\_mm@mod.gov.al

**PALËT NËNSHKRUESE**

**KOMANDANTI I KOLEGJIT TË  
MBROJTJES DHE SIGURISË**

**APLIKANTI**

\_\_\_\_\_  
*(grada, emër, mbiemër)*

\_\_\_\_\_  
*(emër, atësi, mbiemër)*

Konceptoi: \_\_\_\_\_

Pranoi: \_\_\_\_\_

Miratoi: \_\_\_\_\_

Datë: \_\_\_\_\_